Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: _____

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES⁴

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proçes dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴ Kjo deklarate ka si qellim plotësimin e kriterit ligjor qe operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë :

Sipas Krieteve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar :

Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë :

- a) Vërtetim për xhiron mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit ushtrimor duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit , lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë sa 50 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet;
- b) Kopje të certifikuara të bilanceve për tre vitet e fundit ushtrimor duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit.
- c) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga secila prej njësive të qeverisjes vendore të subjektit që ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2019, si dhe vërtetim për vitin 2020 në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 ” Për sistemin e taksave vendore ”.

2.3 Per kapacitetin teknik :

Ofertuesi duhet të dorezojë :

- Punë të ngjashme, për 1 (një) kontratë të vetme të së njëjtës natyrë në një vlerë sa 50 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tre viteve të fundit ushtrimor duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit ose;
- Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera totale e punëve të marra së bashku gjatë tre viteve të fundit ushtrimorë duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit , të jetë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet ;

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme .

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme,Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:
 - a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
 - b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
 - c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.8,*
 - d) *Akt Kolaudimi*
 - e) *Faturat tatimore per cdo situacion*
 - f) Çertifikata (e përkohshme ose e përhershme) e marrjes në dorëzim të punimeve
- Për kontrata për punë publike është realizuar me subjekte private kërkohen:
 - a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
 - b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
 - c) *Formular Vleresimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.8.*
 - d) *Akti i Kolaudimit*
 - e) *Faturat tatimore për çdo situacion,*
 - f) Çertifikata (e përkohshme ose e përhershme) e marrjes në dorëzim të punimeve

2. Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë liçenca profesionale të shoqërisë, për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente Shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI në kategoritë :

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

1. NP – 1 A Punime gjurmimi në tokë.
2. NP – 5 A Punime nëntokësore, Ura dhe Vepra Arti.
3. NP – 6 A Punime në Diga, Tunele hidroteknike.
4. NP – 7 A Punime në Ujësjellës, Gazsjellës, Vajsjellës, Vepra Kullimi dhe Vaditës.
5. NP – 9 A Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime.
6. NP– 12 A Punime të Inxhinierisë së Mjedisit.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

1. NS - 5 A Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut. (*E nevojshme për shkak se tyneli që do të hapet, do të kalojë pikërisht mbi një rrugë egzistuese me qarkullim të lartë të mjeteve dhe është e nevojshme për orientimin e tyre*).
2. NS - 8 A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.
3. NS - 9 A Punime Strukturore speciale.
4. NS-18 A Punime topogjeodezike .

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

3. Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet .

- a. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë inxhinierët e mëposhtëm :

1) Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
2) Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
3) Inxhinier Mekanik	1 (një)
4) Inxhinier Topograf	1 (një)
5) Inxhinier Mjedisi	1 (një)
6) Inxhinier Gjeolog	1 (një)

- 7) Inxhinier Infrastruktura Transporti 1 (një) (*I/E nevojshëm prania e këtij inxhinieri për shkak se tyneli që do të hapet, do të kalojë pikërisht mbi një rrugë egzistuese me qarkullim të lartë të mjeteve , dhe mendimi i specializuar i tij ndihmon në zbatimin e kontratës me sukses duke arritur qëllimin e autoritetit kontraktor që përpos punimeve që do të kryhen, mos të krijojë dëme anësore në rrugë).*

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për çdo muaj për një periudhë 1 vjeçare, duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit .

Për secilin duhet të paraqiten :

Kontratë punë e noterizuar, Diplomë .

Si dhe dy prej inxhinierëve të mësipërm duhet të jenë të pajisur me çertifikatë trajnimi për “ Përgjegjës/Kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë ”, përgjegjës për sigurinë, të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)*, ku njeri prej tyre duhet të jetë inxhinier Hidroteknik .

4. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si më poshtë :

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar **1 (një)** topograf i mesëm i nevojshëm për punimet në terren për të cilin duhet të paraqesë : kontrate noteriale pune, diplomë, licensën përkatëse si dhe të figurojë në listëpagesë.
- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar **2 (dy)** punonjës të pajisur me çertifikatën e trajnimit “ Punonjës të ndihmës së shpejtë ”e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë si dhe të figurojnë në listëpagesa, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm :

Kontratë punë të vlefshme, çertifikatat e trajnimit .

- Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga administratori i shoqërisë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera si dhe të deklarojë që nuk është i/e punësuar në punëmarrje tjetër publike ose private, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm :

Kontratë punë të vlefshme, Diplomë.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar për 5 (pesë) muajt e fundit duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit si staf teknik, punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimit të sigurimit teknik të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, **ose certifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)**, ku të jenë të përfshirë punonjësit si më poshtë :

NR	EMERTIMI	
1	Teknik Ndërtimi	(1 person)
2	Hekurthyes	(1 person)
3	Mekanik	(2 persona)
4	Saldator	(2 persona)
5	Manovratorë	(5 persona)
6	Inxhinier Ndërtimi	(1 person)
7	Inxhinier Hidroteknik	(1 person)
8	Inxhinier Gjeolog	(1 person)
9	Inxhinier Mekanik	(1 person)

Për secilin punonjës duhet të paraqiten :

Kontratë individuale të punës

Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik .

Për manovratorët të paraqitet dëshmia e aftësisë profesionale (të vlefshme) të lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe Policat e Sigurimit të Aksidenteve Personale .

- 5. Operatori/ ekonomik ofertues** duhet të paraqesin dëshmi nga administrate tatimore ku të ketë një punësim mesatar i të paktën 50 (pesëdhjetë) punonjësve për periudhën 1 vjeçare duke filluar nga data e zhvillimit të tenderit, të vërtetuar me :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj .
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **1 vjeçare**, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (sistemi E-Sig).

- 6. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht :**

- **ISO 9001:2015** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), **ose ekuivalent**
- **OHSAS 18001-2007** (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme), / **ISO 45001-2018** , **ose ekuivalent i tyre**

- **ISO 14001-2015** (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), *ose ekuivalent*
 - **PAS 99-2012** (Sistemi i Integruar i Menaxhimit e vlefshme), *ose ekuivalent*
 - **ISO 39001:2012** (Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor), *ose ekuivalent* (E nevojshme për shkak se tyneli që do të hapet, do të kalojë pikërisht mbi një rrugë egzistuese me qarkullim të lartë të mjeteve dhe është e nevojshme për orientimin e tyre)
 - **DS CEN/TR 15128:2005** (Riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe Kullimit) *ose ekuivalent*
 - **ISO 3834-2:2006** (Sistemi i menaxhimit të cilësisë për saldim me shkrirje të materialeve metalikë) *ose ekuivalent* .
7. Operatori Ekonomik ofertues duhet që të disponojë licencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportime mbetje Urbane”.

Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjës /Kontrate shërbimi me subjekt të licensuar. Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktura, Republika e Shqipërisë, sic percaktohet në *Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, datë 16.01.2008* .

8. Operatori ekonomik ofertues Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamiona vetshkarkues mbi 18 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamiona Vetshkarkues 7.5-18 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçina deri në 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompë për hedhje betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	4 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere Kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrom (Skrep)	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul Ngjeshës	1 copë	Pronësi ose me qera
Motosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

Hekur kthyese, Prerëse	1 copë	Pronësi ose me qera
Tabela (kantieri)	20 copë	Pronësi ose me qera
Kaska – kokore	30 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator	3 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	2 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
Fikse Zjarri	5 copë	Pronësi ose me qera
Kuti ndihme e shpejtë	5 copë	Pronësi ose me qera
Karroca dore	10 copë	Pronësi ose me qera
Depozita uji	4 copë	Pronësi ose me qera
Kontenier Stacioner (zyre në objekt)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kokë tërheqëse)	1 copë	Pronësi ose me qera
Rimorkio ose Gjysërimorkio	1 copë	Pronësi ose me qera

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.10 dhe dokumentacioni si më poshtë :

- a) *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksën vjetore si dhe certifikatën e transportit të mallrave të vlefshme .*
- b) *Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme), taksën vjetore si dhe certifikatën e transportit të mallrave duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- e) *Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës .*

9. Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë :

Impiant prodhim Betoni me QKL	1 copë	Pronësi, me qera ose kontratë furnizimi
Impiant prodhim Inertesh me QKL	1 copë	Pronësi, me qera ose kontratë furnizimi

Për sa më sipër duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë apo marrjes me qera, të shoqëruar me leje mjedisore të lëshuar nga QKL si më poshtë :

-QKL - Leje Mjedisi të tipit B, Kodi: III.1.B “Për impiant betoni, prodhimin e produkteve te betonit, shoqëruar me planvendosjen për Impiantin,monitorimin mjedisor lëshuar 6 muajt e fundit.

-QKL – Leje Mjedisi Kodi: III.1.B. “Për Impiant Inertesh”

-Impianti i prodhimit të betonit nuk duhet të jetë më shumë se 50 km nga objekti (në rast se është platformë e palëvizshme) dhe të shoqërohet me planvendosje e firmosur nga një topograf vendodhja e impiantit të betonit (me qëllim verifikimi i saktë nga ana e KVO-së) .

Per impiantin e prodhimit te Inerteve dhe Impianti i prodhimit te Betonit operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese raport testimet per materialet si me poshte:

- Raport Testim të Materialeve Inerte Granil, Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012. Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012

-Raport Testimi të materialeve Inerte Rërë e Larë Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012. Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012

- Raport Testimi nga Impianti i Prodhimit metoda e e testimit S SH EN 12390 -1: 3 2009 , SSH –EN 12390 1: 3 – 2009 për mostrën e betonit.

- Raport Testimi nga Impianti i Prodhimit i Ujit për Beton, metoda e testimit S SH EN 1008 : 2002

- Testimet e mësipërme duhet të jenë nga Laborator i akredituar konform S SH ISO/EN 17025;2006

Raport i testeve duhet të jetë sipas standarteve në fuqi bazuar në ligjin Nr.9290 datë 07/10/2004 “ Për Produktet e Ndërtimit”. Raport testimet duhet të jenë 6 – mujorin e fundit .

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të plotësojë kriteret e mësipërme (për kapacitetin ekonomik, financiar dhe teknik) , sipas nenit 74 të VKM 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar, në raport me përqindjen e punës që ka marrë përsipër të kryeje, sipas akt-marrëveshjes së lidhur midis operatorëve ekonomik .

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim .

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVI i PUNIMEVE

Nr	NR.An a	Emërtimi i Punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	3.104/a	Gërmim dheu me eskavator zinxhir 0.5 m ³ , në kanale gjerësi deri ne 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	m3	1,250		
2	3.101/b	Germim dheu me eskavator zingjir, 0.5 rn ³ , në kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke	m3	8,500		
3	An-9	Mbushje me zhavorr pas mureve te betonit	m3	65		
4	3.158/5a	Transport dheu me mjet deri 5 km	m3	600		
5	3.243	Struktura monolite betoni C-16/20 mure barazhi	m3	200		
6	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C-16/20 veshje kanali	m3	100		
7	3.287	F.V. hekur i zakonshem < Ø 10mm	ton	7.0		
8	3.288	F.V. hekur i zakonshem > Ø 12mm	ton	10.5		
9	3.294	F.V konstruksione metalike të përbëra	ton	1.5		
10	3.644	Porte metalike me ngritje me krahe	ton	2.10		
11	3.244/1	Struktura monolile betoni C-20/25 tombino katrore	m3	100		
12	3.242	Shtrese betoni nen tombino katrore	m3	15		
13	718-720	Germim tuneli me makine shpimi ne seksion 20 ~ 40 m ² , K = 6 ~ 10	m3	700		
14	3.369	Tombino me tuba betoni Ø 1500, mbi shtrese betoni	m	100		
15	3.331	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m	m3	150		
16	3.761	Beton C 25/30 per tunele, me beton pompë -~ 30 m ²	m3	100		
		SHUMA PA TVSH				
		TVSH 20%				
		SHUMA ME TVSH				

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

Shtojca 16

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

Dokumenta Standarde të Tenderit

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS **Punët – Procedura e Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit

të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezyrtshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

